



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 1824/1 Prishtinë 02.06. 2022

## PUBLIKIMI I ABSTRACTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti Shqipron Maloku ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "Pendat e ulëta për ujite, studimi mbi ndërtimin e tyre në lumen Llap" në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

### Abstrakt

Menaxhimi i ujërave sot është një sfidë globale që ndikon në çdo drejtim të jetës si në aspektin ekonomik, social, mjedisor e politik. Nevojat për ujë çdo ditë vijnë duke u rritur. Uji është njëri ndër faktorët kryesorë për zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë.

Në tërësi ndoshta uji do të kishte mjaft që të plotësohen të gjitha nevojat, mirëpo uji sikur kërkon apo tenton të gjendet në vend të papërshtatshëm, në kohë të gabuar edhe me kualitet të gabuar. Prandaj është e domosdoshme që të punohet kujdeshëm me ujërat në të gjitha fazat.

Një zgjidhje adekuate dhe e përshtatshme që uji të akumulohet dhe të shfrytëzohet në kohën e duhur është përmes digave (penda). Digat janë objekte hidroteknike të cilat vendosen normal me drejtimin e rrjedhës së lumbit për qëllime të ndryshme: për krijimin e rezervuarve të ujit, ngritjen e nivelit të ujit, mbrojtje nga ujërat e mëdha etj.

Një faktori i rëndësishem në rritjen e rendimenteve bujqësore është ujitja e bimëve në kohën e caktuar dhe në sasin e duhur. Mundësia e shfrytëzimit të lumbit Llap për ujite është e madhe andaj përveq sipërfaqes së kërkuar për përfshirje në sistemin e ujites përfshirje në caktuara kjo sipërfaqe mund të rritet edhe për 50% më shumë.

Hulumtimi është ndarë në dy pjesë ku pjesa e parë ka të bëjë me hulumtimin në literaturë, kurse pjesa e dytë me analizë të rastit studimor nga aspekti gjeografik, gjeologjik, hidrologjik, ambiental e ekonomik.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.